

VENDIM
Nr.827, datë 6.10.2010

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.488, DATË 23.4.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË
SË DREJTËSISË TË PRONËS SË PALUAJTSHME, NR.663, TRUALL, ISH-REPARTI
USHTARAK I ARTILERISË, NR.6650 NË PARANGUA, BERAT, SI DHE PËR NJË
NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË
PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT JANË NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË MBROJTJES”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.488, datë 23.4.2008 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Në titullin e vendimit, fjalët “... nr.663, truall, ish – repartit ushtarak i artilerisë, nr.6550 në Prangua...” zëvendësohen me “...nr.1025 “Objekte të repartit ushtarak nr.5013”, me vendndodhje në Dushnik...”.

2. Në pikën 1, fjalët “...nr.663, truall, zona kadastrale 8505 k-34-112-(223-b), ish-repartit ushtarak i artilerisë, nr.6550, në Prangua, Berat, zëvendësohen me “...nr.1025 “Objekte të repartit ushtarak nr.5013, me vendndodhje në Dushnik, Berat, e cila ndodhet në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes...”.

3. Ngarkohen Ministri i Drejtësisë, Ministri i Mbrojtjes dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha